



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:171233
Datë: 22.01.2025
Numri i dokumentit: 06742256

Rev.nr.288/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Zenel Leku dhe Milena Deric, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. (A.) G. nga I., të cilin e përfaqëson Arben Kelmendi avokat nga Peja, sipas autorizimit, kundër të paditurës Telekom i Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga G. L., sipas autorizimit, me objekt të kontestit kompensim dëmit dhe rritje grade, vlera e kontesti, 12,362.00 euro, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.700/2022, të datës 21.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i paditësit A. G., nga I., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.700/2022, të datës 21.03.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin C.nr.343/19, të datës 30.12.2021, Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, ka vendosur si në vijim: *“I. Refuzohet në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, A G., nga I., me çka ka kërkuar që të : Detyrohet e paditura Telekom i Kosovës – SH.A., me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës për periudhën kohore nga data 01.01.2016 e deri në realizimin e saj ti paguaj shumën e pa realizuar për 2 grada nga grada 5 e që do duhej të ishte 7, si në vijim: kompensimi në emër të pagës-diferencës, neto me pak të paguar, data 01.01.2016, deri me datë 31.05.2021, shuma prej 10.021.63 euro, Kompensimi në emër të kamatës së pa paguar për periudhën kohore nga data 01.01.2016, deri me dt. 31.05.2021, shumën prej 2,340.98 Euro, në total shumën prej 12,362.61 (Dymbëdhjetë mijë e gjashtëqindë e dy euro e gjashtëdhjetë e një cent), e të gjitha këto me kamat ligjore 8 %, sipas LMD-së, nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në përmbushje të plotë, Detyrohet e paditura ne kthimin e gradës nga grada 5 në gradën 7, dhe atë në bazë të pozitës*

dhe përgjegjësisë në detyrë- punë, në harmoni me pozitën e njëjtë, si dhe në pagesën e diferencës e pagesës nga grada 5, nga data 01.01.2016 e deri në kthimin e të ardhurave mujore sipas gradës 7, Obligohet e paditura që ti paguaj shpenzimet e procedurës paditësi në shumë prej, 1,505.60 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi në kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të paditësit, me aktgjykimin Ac.nr.700/2022, të datës 21.03.2024, ka vendosur që të refuzoj si të pathemeltë ankesën paditësit A. G., ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin C.nr.343/19, i datës 30.12.2021, të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të pranoj revizionin e të paditurës, ashtu që të prishen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë me datë 08.08.2019, duke kërkuar nga gjykata kompensimin e dëmit dhe diferencën e pagës më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancë për shqyrtimin kryesor të çështjes, dhe pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse mori aktgjykimin C.nr.343/19, të datës 30.12.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka theksuar se nuk ka qenë kontestuese rrethana se paditësi A. G., është punëtor tek e paditura Telekom i Kosovës. Meqenëse pala e paditur është thirrur në parashkrimin të kërkesës gjykata pas vlerësimit të afatshmërisë të padisë respektivisht të kërkesëpadisë, ka vërtetuar rrethanën se kërkesëpadija e paditësit A. G., e ushtruar kundër të paditurës Telekom i Kosovës Sh.a., me seli në Prishtinë është e parashkruar për faktin se paditësi kontratën e punës me të paditurën e ka lidhur me datën, 22.12.2015, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.06.2016, ndërsa padinë në gjykatë e ka dorëzuar me datën 08.08.2019, që i bije se e njëjta është dorëzuar pas afatit 3 vjeçar, përkatësisht pas kalimit të afatit prej 3 vite, 7 muaj e 7 ditë, afat kohor i përcaktuar me dispozitën e nenit 87, të Ligjit të Punës i cili në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, ka refuzuar të pathemeltë ankesën, duke vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë edhe pretendimet tjera të paraqitura me ankesë.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të paditësit vlerëson se të njëjtat janë të pa themelta. Nga shkresat e lëndës vërehet se paditësit ka nënshkruar kontratën e punës me të paditurën me datën 22.12.2015. Neni 5 i kësaj kontrate ka paraparë se paditësit i është caktuar paga bazë në lartësi të gradës 5 sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve nr. 01-1630/05, i datës 28.02.2005. Kontrata është nënshkruar nga të dyja palët, si nga pala paditëse ashtu edhe nga e paditura dhe kjo kontratë ka paraparë në nenin 3 se do të hyjë në fuqi që nga data 01.01.2016. Kolegji i kësaj Gjykate vlerëson se në rastin e paditësit nuk mund të vihet në përfundimin se tek paditësi ekziston ndonjë formë e diskriminimit sa i përket punës, kushteve të punës apo pagës që e merr paditësi nga ana e të paditurës.

Pretendimet e paditësit se i njëjti merr pagë të njëjtë me vartësit e tij përkundër pozitës së tij si udhëheqës për Gjykatën e Apelit mbeten vetëm në nivelin deklarativ pasi që me asnjë provë të vetme nuk është provuar fakti se e paditura e ka diskriminuar në pagë të njëjtin dhe se paditësi nuk ka mundur që ta bëjë të besueshëm faktin se udhëheqësit komunal në Departamentin e Shitjes kanë pagë më të lartë apo më të ulët se sa punëtorët e tjerë që punojnë në këtë Departament. Për më tepër Gjykata e Apelit vlerëson se çështja e pagave është çështje e brendshme e punëdhënësit ku i njëjti në bazë të mundësive financiare dhe organizimit të brendshëm e cakton edhe lartësinë e pagës, e që në këtë Gjykata nuk ka kompetencë që të ndërhyjë. Në rastin konkret është kërkuar kompensimi i diferencës së pagës, e që sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, krijohet bindja edhe për Gjykatën ankimore se nuk ekziston bazë juridike për kompensimin e këtyre pagave, pra me vetë faktin se kontrata është nënshkruar. Në qoftë se paditësit nuk ka qenë i pajtimit lidhur me kushtet e kontratës dhe kushtet e punës i njëjti ka mund të zgjedhë që ta refuzojë punën dhe të mos e lidhë kontratën fare. Kjo Gjykatë edhe njëherë potencon se përcaktimi i detyrave të punës si dhe organizimi i punës janë çështje të brendshme të punëdhënësit në të cilat Gjykata nuk ka kompetencë që të ndërhyjë e po ashtu edhe pranimi i përgjegjësive shtesë është çështje e paditësit, dhe kjo nuk ka fare ndikim në themelësinë e kërkesës së paditësit. Gjykata e Apelit

gjatë vlerësimit të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar në bazë të parashkrimit, por kjo Gjykatë siç është cekur edhe më lartë ka gjetur se në këtë rast nuk ekziston baza juridike për aprovimin e kërkesëpadisë me vet faktin se është lidhur kontrata e re me kushtet e të cilës është pajtuar paditësi, andaj lidhur me çështjen e parashkrimit Gjykata e Apelit nuk është lëshuar fare.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Përkundër faktit se pala paditëse, përkatësisht i autorizuari i tij në revizionin e paraqitur është thirrur në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga dispozita e nenit 182.1 dhe 182.2 pika n) të LPK-së, mirëpo shprehimisht nuk ka përmendur ku qëndrojnë këto shkelje dhe si kanë ndikuar të njëjtat në vendimmarrje nga gjykatat e instancave më të ulëta. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës dhe përmbajtjes së aktgjykimeve të atakuara, rezulton se të njëjtat janë hartuar në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 160 të LPK-së, duke përmbajtur arsye të mjaftueshme mbi vërtetimin e fakteve vendimtare dhe për zbatimin e të drejtës materiale. Përveç kësaj, kjo gjykatë ka trajtuar aktgjykimin e shkallës së dytë edhe në aspektin e ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Si rrjedhojë, sipas Gjykatës Supreme aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të pretenduara me revizion sikurse më lartë, apo me shkelje nga neni 215 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Në lidhje me këtë është i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi juridik i gjykatave të instancave më të ulëta se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar, meqenëse ka rezultuar se i njëjti ka nënshkruar kontratën e punës me të paditurën nr.01-5740-210/2015, me datën 22.12.2015. Ndërsa neni 5 i kësaj kontrate ka paraparë shprehimisht se paditësit i është caktuar paga bazë në lartësi të gradës 5, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve nr. 01-1630/05, i datës 28.02.2005. Kontrata është nënshkruar nga të dyja palët, si nga pala paditëse ashtu edhe nga e paditura dhe kjo kontratë ka paraparë në nenin 3 se do të hyjë në fuqi që nga data 01.01.2016.

Në lidhje me këtë, më nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: *“Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshinë elementet e përcaktuara sipas neni 11 të këtij ligji”*. Me nenin 11 të këtij ligji përcaktohet se: *“Çfarë duhet të përmbaj kontrata e punës”*, ndërsa në paragrafin 1 pika 1.8 të këtij neni përcaktohet lartësia e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër. Me nenin 55 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuarit i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës”*.

Si rrjedhojë, në rastin konkret gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar në pajtim me këto dispozita ligjore duke e konstatuar drejtë faktin që paditësi me të paditurën ka themeluar marrëdhënie të re të punës duke e nënshkruar kontratën e punës nr.01-5740-210/2015, me datën 22.12.2015. Me këtë kontratë palët kanë përcaktuar vendin e punës-pozitën, kohën kur ka hy në fuqi kontrata dhe lartësinë e pagës.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e palës paditëse, pasi drejtë ka konstatuar faktin që paditësi me palën e paditur ka themeluar marrëdhënie pune sipas kontratës së punës nr.01-5740-210/2015, datë 22.12.2015, ku me kontratë janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes palëve, përkatësisht është përcaktuar vendi i punës të cilën paditësi duhet ta kryej te e paditura, si dhe lartësia e pagës dhe paditësi në kohën e nënshkrimit të kontratës ka qenë në dijeni për vendin e punës dhe lartësinë e pagës, ndërsa ka pranuar që kontratën ta nënshkruaj me këto kushte. Me nënshkrimin e kontratës paditësi ka krijuar raport të ri kontraktues nga marrëdhënia e punës me të paditurën dhe se tani nuk mund të kërkojë që të ndryshohet koeficienti i pagës. Në rrethana të tilla kur vetë paditësi ka nënshkruar kontratën e re dhe e ka pranuar pozitën e re të punës dhe gradën 5, rezulton se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjor që të kërkohej kompensimi i pretenduar mes gradës 7 dhe 5 që është me kontratë. Diferenca do të vinte në shprehje sikur paditësi mos të nënshkruante kontratë të re të punës dhe kontrata e parë të ishte në fuqi, ndërsa e paditura pa asnjë bazë ligjore do ja ulte pagesën sipas gradave të pretenduara.

Në rrethana të tilla kjo gjykatë e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë se paditësi ka nënshkruar kontratën me palën e paditur, ka pranuar kushtet e kontratës duke përfshi edhe lartësinë e pagës, ndërsa me asnjë provë nuk ka dëshmuar të ketë pasur të meta në vullnetin e shprehur me rastin e lidhjes së kontratës dhe në lidhje me lartësinë e kompensimit në pagë për periudhën për të cilën kërkohej kompensimi sipas kërkesëpadisë.

Në anën tjetër, Gjykata Supreme e pranon edhe qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, rreth refuzimit të pretendimit të paditësit se është diskriminuar nga e paditura si punëdhënës në lidhje me çështjen e përcaktimit të gradës, përkatësisht lartësisë së të ardhurave personale. Si rezultat i kësaj, qëndron konstatimi i gjykatës së shkallës së dytë lidhur me këtë pretendim të paditësit, se tek ky i fundit nuk është provuar me asnjë provë konkrete se ekziston ndonjë formë e diskriminimit sa i përket punës, kushteve të punës apo pagës që e merr paditësi nga ana e të paditurës. Në lidhje me këtë, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L-021 Për Mbrojtje nga Diskriminimi Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 16 / 26 qershor 2015, Prishtinë, saktësisht në dispozitat e neneve 4 dhe 5, ka përcaktuar saktësisht format dhe mënyrën e manifestimit të diskriminimit, përfshirë këtu edhe marrëdhënien e punës. Mirëpo, referuar shkresave të lëndës, rezulton se gjykata e shkallës së dytë me të drejtë ka konstatuar se në rastin e paditësit nuk është provuar ndonjëra nga format e diskriminimit nga e paditura, e që për rezultat edhe do të kishte marrjen e ndonjë vendimi ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Gjykata Supreme e pranon edhe qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale, pasi që kjo e fundit me të drejtë ka konstatuar se në rastin e paditësit ka rezultuar se nuk ekziston baza juridike për aprovimin e kërkesëpadisë, me vet faktin

se është lidhur kontrata e re me kushtet e të cilës është pajtuar paditësi, e jo siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë kur e ka refuzuar të njëjtën për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit (*meqenëse konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare për zbatimin e të drejtës materiale*).

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Rev.nr.288/2024, më 20.01.2025

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari

Lumni Sallauka